

Radikalët muslimanë janë „westernizuar“ në mënyrë të përkryer

Intervistë me Olivier Roy



Olivier Roy, ndër të tjera edhe autor i
The Failure of Political Islam
(Dështimi i Islamit Politik)

Olivier Roy është njëri prej ekspertëve më të famshëm sa i përket Islamit politik. Në këtë intervistë me Michael Hesse, ai flet për fundamentalizmin fetar, Islamit në Evropë, si dhe jep sqarime se pse klasat e mesme të muslimanëve në Perëndim duhet të njihen si një komunitet fetar perëndimor, e jo si një kulturë e huaj.

Z. Roy, a janë vështirësitë e Evropës me muslimanët e saj çështje e një thjeshtëzimi histerik?

Olivier Roy: Më së paku e një thjeshtëzimi. Pamja që paraqitet zakonisht është e një “komuniteti musliman” – duke menduar se të gjithë ata janë të njëjtë, të gjithë të ngjitur pas Islamit – të bashkuar në refuzimin e “vlerave perëndimore” dhe të cilët në Evropë sjellin konfliktet e Lindjes së Mesme. Në fakt popullata muslimane në Evropë është shumë e larmishme, jo vetëm për shkak të origjinës së saj të ndryshme, por edhe për shkak se ata kanë parapëlqime të ndryshme dhe shpesh komplekse, madje edhe kontradiktore.

Disa kujdesen ta ruajnë sa më shumë që të jetë e mundur një kulturë të pacenuar në aspektin e gjuhës, të dietës e të martesës endogamike, të tjerët luajnë në kartën e shekullarizmit, flasin më mirë frengjisht e gjermanisht sesa arabisht apo madje edhe turqisht dhe vetëm tentojnë si e si të jenë të integruar; të tretët, gjithashtu shumë të perëndimozuar, përpiqen ta rimodelojnë një praktikë pastër fetare në një mjedis shekullar perëndimor duke i marrë për model format protestante dhe çifute të përkatësisë fetare; dhe finalisht disa të rinj “të lindur sërish”, të shoqëruar nga të konvertuarit, janë të magjepsur nga një damkë e dekulturnuar fundamentaliste e Islamit, siç është p.sh. *selefizmi*, i cili i kritikon kulturat tradicionale muslimane – kulturën e prindërve të tyre - po aq sa edhe kulturat perëndimore.

Nëse – nga mungesa e një fjale më të mirë – “evropianët tradicionalë” ua mundësojnë muslimanëve që ata të ndihen si në shtëpi si muslimanë të rinj evropianë, a do të ishin ata burim i një pasurimi kulturor dhe i një dinamizmi ekonomik, apo...?

Roy: Ne duhet të bëjmë një dallim midis “komuniteteve fetare” dhe “kulturave etnike”; integrimi zakonisht implementohet në kurriz të kulturave tradicionale etnike, mirëpo Islami mund dhe duhet të rimodelohet si një “komunitet fetar” e pastaj duhet të trajtohet në një hap të barabartë me fetë e tjera. Besimtarët muslimanë, praktikues të Islamit, thërrasin për barazi, e jo për një status të një minoriteti kulturor, mirëpo ata në mënyrë sistematike shtyhen në statusin e një kulture “të huaj” etnike.

Klasat e mesme të muslimanëve që janë gjithnjë në rritje këtu në Perëndim dëshirojnë të njihen si një komunitet fetar perëndimor, e jo si një kulturë e huaj. Ky lloj i praktikës dhe i perceptimit fetar zakonisht përkrahet nga një klasë e mesme e shkolluar dhe gjithnjë në rritje, e cila njëkohësisht është edhe një faktor i rritjes ekonomike.

Ndërkaq lidhjet me vendet e origjinës mund gjithashtu të jenë një vlerë e çmuar, jo në kuptim të kulturës – Turqia për shembull është duke u perëndimizuar në një shkallë shumë të lartë të shpejtësisë – por në kuptim të këmbimit ekonomik: në rastin e Turqisë, ku është shënuar një rritje mahnitëse ekonomike dhe një ndryshim po aq i madh social në 20 vitet e kaluara, përfitimi i ndërsjellë midis vendit mysafir dhe vendit të origjinës është shumë i qartë. Kompanitë e përbashkëta dhe ardhje-shkuarjet e njerëzve të shkolluar e të biznesit po i ndryshojnë format e “emigrimit”: nuk ka më ndonjë presion nga punëtorët e pakualifikuar e të varfër që lakmojnë të vendosen në Perëndim; tani ajo që më tepër po ndodh është një shkëmbim. Imigrimi gjithashtu ka kontribuar edhe në zhvillimin e vendit të prejardhjes, andaj sot të dyja shoqëritë janë më shumë konvergjente sesa divergjente.

Çka në qoftë se ne dështojmë, a do të ketë sulme të rregullta vetëvrasëse në Londër, Paris, Berlin...?

Roy: Nuk mendoj që situata është kaq tragjike. Nuk do të jenë në pyetje “emigrantët muslimanë” kundër “shoqërisë së bardhë”, ngase shumë muslimanë tanimë janë integruar, madje edhe pse integrimi i tyre nuk është njohur plotësisht.

Në fakt nëse ne dështojmë, atëherë sigurisht që do të ketë tri lloje radikalizimi: një grup i gjeneratës së dytë të të rinjve, pa marrë parasysh se ç’sfond social apo ekonomik kanë, do të joshet nga një radikalizim i dhunshëm islamist; pjesa më e madhe e të rinjve të privuar nga e drejta e qytetarisë, të papunë e të pashkolluar më mirë do të kënaqet në kundërvajtje të vocrra e në ekonominë gri, me shpërthime përplasjesh me policinë por pa dimensione fetare; dhe finalisht disa mjedise tradicionale konservative do të mbyllen brenda një getoje kulturore dhe fetare.

A do të thoshit se në Evropë janë duke u përplasur kultura evropiane me kulturën muslimane?

Roy: Debati – karikaturat daneze, blasfemia, liria e shprehjes – nuk ndodh midis një Perëndimi liberal dhe një Lindjeje obskurantiste. Shumë konservatorë fetarë evropianë janë për kufizimin e lirisë së shprehjes, si p.sh. Kisha Katolike Franceze ka fituar një betejë gjyqësore para dy vitesh për ta ndaluar një reklamë që përdorte “The Last Supper” (Darkën e fundit) në një formë kinse ofenduese – ku apostujt ishin zëvendësuar me femra të reja gjysmëlakuriqe. Shumë peshkopë katolikë e kundërshtojnë martesën e homoseksualëve. Në

këtë kontekst edhe shumë muslimanë e kritikojnë ashpër mungesën e lirisë e të demokracisë në vendet arabe, regjimet e të cilave ne po i mbështesim zaten, si p.sh. Tunizia e Egjipti.

Ky nuk është një debat kulturash, porse një debat vlerash, dhe debati është duke ndodhur pikërisht brenda Evropës – a duhet ta konsiderojmë Kishën Katolike Spanjolle si muslimane vetëm nga arsyeja se e kundërshton shekullarizimin, ndarjen e kishës nga shteti, martesën e homoseksualëve dhe lirinë absolute të fesë?

Një pikë e fundit: vultat moderne të fundamentalizmit (*vehhabizmi*, por gjithashtu edhe evangjelizmi protestant) nuk janë produkt i kulturave tradicionale, por përkundrazi produkt i një krize të kulturave tradicionale, produkt i dekulturizimit dhe globalizimit. Tensionet fetare kanë lidhje me krizat e kulturave tradicionale dhe *nuk* janë shprehje e tyre.

Shkencëtarët e theksojnë diversitetin kulturor të mërgimtarëve muslimanë në Evropë. Andaj, a është e mundshme të supozojmë se ekziston diçka që mund të quhet unitet fetar në Islam?

Roy: Imigrantët nuk i takojnë ndonjë kulture specifike apo ndonjë grupi të caktuar etnik. Martesat e përziera, ndryshimet gjuhësore, ndryshimi i qytetarisë... i lëkundin identitetet tradicionale. Mirëpo çfarë po bëjmë ne kur po flasim për një “komunitet musliman”? Ne me këtë e përdorim fenë si një mënyrë për të krijuar një identitet të ri etnik dhe kulturor. Ne e përdorim termin “musliman” si një term neo-etnik. Në fakt, faktori i vetëm i përbashkët ndër shumë imigrantë të brezit të dytë e të tretë është Islami thjesht si fe, e jo si kulturë. Dhe ne nuk dëshirojmë ta shohim shpëputjen e lidhjes gjithnjë në rritje midis Islamit si fe dhe Islamit si kulturë. Ne i shtyjmë të rinjtë muslimanë drejt një identiteti etno-kulturor, çka shumica prej tyre e refuzojnë. Ata dëshirojnë të konsiderohen si “muslimanë” dhe “qytetarë”, e jo si “qytetarë muslimanë”. Mirëpo ata nuk ndihen të mirëseardhur në këtë drejtim.

Sa i takon Islamit si fe, aty ekzistojnë shumë rryma. Unë e potencova rolin e *selefizmit* në fenomenin e besimtarëve të rinj “të lindur sërish”, që e rizbulojnë besimin dhe praktikën fetare. Mirëpo, në shumë raste njerëzit nuk e konsiderojnë vetveten si “të lindur sërish” për pjesën e mbetur të jetës së tyre. Radikalizimi është një fenomen breznie. Trajektoret individuale janë shumë më shumë komplekse dhe e përfshijnë gjithë diversitetin dhe tendencat në Islam.

Sufizmi, për shembull, gëzon një zhvillim të mrekullueshëm në Perëndim po edhe në Turqi, Egjipt dhe Marok, dhe ai tërheq shumë të konvertuar. Mendimtarët e rinj flasin haptas për “reformë”, ndërkohë që shumë konservatorë e theksojnë faktin se *Sheriati* më shumë është për vlera sesa për ligje. Në sajë të demokracisë perëndimore mendimtarët e rinj muslimanë gjejnë më shumë hapësirë në Evropë sesa në të ashtuquajturat regjime arabe shekullariste – por megjithatë autoritariste.

Ç’është mendimi Juaj rreth nocionit Islamo-fashizëm?

Roy: Kjo thjesht nuk ka kuptim. Fashizmi është një sistem ligjesh, institucionesh e ideologjish të përqendruara në një fuqi dominuese dhe gjithëpërfshirëse. Mirëpo nëse i referohemi Islamit si fe, ai është sikurse Krishterimi: një përzierje besimesh, normash dhe vlerash; shteti dhe ideologjia nuk janë problem. *Sheriati* nuk është ideologji politike, ai është një sistem juridik, i cili mund të shihet si i vjetërsuar, konservativ, patriarkal, mirëpo ai deri vonë është përdorë si një referencë politike. *Sheriati* kurrë nuk është zhvilluar nga ana e shtetit; përkundrazi: çdo përpjekje nga ana e shtetit për ta promovuar *sheriatin* bëhet ose në dëm të shtetit, sepse ai e humb kontrollin e drejtësisë, ose në dëm të *sheriatit*, kur shteti e

transformon procesin zhvillimor të normave adaptuese ndaj realitetit në një kod shtetëror. Përkundrazi: fashizmi mendon se ligji përcaktohet nga shteti, e jo nga një rreth i pavarur i dijetarëve.

Islamizmi politik, si në rastin e Iranit apo të Vëllezërve Muslimanë, përkundrazi është mbështetur në Islamin si një ideologji, e jo si një sistem juridik. Në grupet radikale islamiste mund të ketë disa elemente që na përkujtojnë komunizmin dhe fashizmin, siç është rasti për shembull me partinë shekulare arabe Baas, mirëpo kjo është një instrumentalizim i referencave fetare në fushën politike, e jo një zhvillim logjik i Kur'anit dhe i Traditës së Profetit (Muhammed).

Nëse i referohemi Islamizmit, pra Islamit si një ideologji politike, kjo është diçka më e re, kjo shkon prapa deri në vitet 1920; dhe i ka dhënë shkas paraqitjes së një spektri të gjerë të qëndrimeve politike, që nga Vëllezërit Muslimanë e deri te partia AK në Turqi. Mu ashtu si marksizmi që i dha shkas paraqitjes së Walter Ulbrichtit dhe Willy Brandit.

Çfarë duhet bërë kundër fundamentalizmit islamik dhe terrorizmit të Al-Kaidës?

Roy: Nuk është e njëjta gjë. Jo të gjithë fundamentalistët janë radikalë politikë dhe së këndejmi në fakt ka shumë pak fe në Al-Kaida. Fundamentalizmi është një trend permanent në çdo religjion dhe nuk ka kuptim që nga jashtë të promovohet një islam "i mirë"; fundamentalizmi gjithnjë do t'i tërheqë disa njerëz. Çështja qëndron aty që të krijohet hapësirë për një shumicë islame të besueshme, e cila do t'i plotësojë kërkesat fetare të pjesës dërmuese të muslimanëve. Ne duhet t'i ikim kurthit të Bin Ladenit: Perëndimi mendon se Islami i duartroket radikalizmit, së këndejmi dhe ne në mënyrë automatike e shohim Bin Ladinin si një avangardë (pararojë) të botës muslimane. Përkundrazi, ne duhet ta luftojmë atë si një terrorist e jo pse është musliman.

Në fakt, terroristët e rinj nuk bëhen terroristë nga arsyeja se kanë shkuar në xhami dhe se kanë lexuar Kur'an. Atyre u intereson aksioni. Ata janë trashëgimtarë të vërtetë të ultra-majtistëve të viteve 1970: të pushtuar nga Amerika dhe nga Wall Street, ata më shumë janë anti-imperialistë sesa përkrahës të *shariatit*. Nëse i shikon skenat e filmuara të heqjes së kokës së pengjeve në Irak: kjo ta përkujton mbytjen e Aldo Moros nga brigadat e Kuqe në Itali dhe aspak nuk ka të bëjë me shëmbëlltyrën tradicionale muslimane.

Rrëfimi i terroristit të ri është ai i një heroi individual që kërcen për ta ruajtur *ummetin* nga barbarizmi perëndimor. Feja nuk luan ndonjë rol të madh në procesin e radikalizimit individual. Ne duhet ta deligjitimojmë këtë heroizëm, ta demaskojmë rrëfimin e heroizmit, në vend që ta thërrasim komunitetin musliman ta dënojë terrorizmin.

Le të pushojmë të flasim për fenë dhe kulturën, që në këtë stad janë irrelevante, dhe le të flasim për politikën dhe radikalizimin e breznive.

Çfarë duhet të kuptojmë nga multikulturalizmi?

Roy: Asgjë. Ai është një slogan që pretendon ta menaxhojë bashkëjetesën e grupeve të ndryshme kulturore në një kohë kur identitetet kulturore janë në krizë. Multikulturalizmi supozon se Islami si fe është futur në një kulturë të huaj dhe vazhdon të mbijetojë nga brezi në brez. Dikush mund të jetë një qytetar i mirë dhe në të njëjtën kohë të identifikohet para së

gjithash me një kulturë që nuk është dominuese. Me fjalë të tjera, lidhja e qytetarit me kombin mund të ndërmjetësohet me një ndjenjë komunitariane të përkatësisë.

Mirëpo problemi është se ringjallja e sotme fetare – qoftë në format fundamentaliste qoftë në ato spiritualiste – zhvillohet duke u çlidhur (çkyçur) nga çfarëdo një referencë kulturore. Ajo lulëzon nga de-kulturizimi: radikalët e rinj në të vërtetë në mënyrë të përkryer janë “westernizuar” (perëndimizuar). Në mesin e besimtarëve “të lindur sërish” dhe të konvertitëve Islami nuk shihet si një relik t kulturor, por si një fe që është universale, globale dhe që i tejkalon kufijtë e cilësdo kulturë, mu si Evangjelizmi apo Pentakostalizmi.

Tariq Ramadan, një reformator musliman, insiston se Islami, i interpretuar në mënyrë të përshtatshme, nuk ka nevojë për konflikt me Evropën demokratike. A ka të drejtë?

Roy: Po sigurisht që ka të drejtë, mu sikur Judaizmi konservativ ortodoks, Protestantizmi evangjelic apo Katolicizmi konservativ që nuk kanë konflikt ... ose kanë konflikt. Ato kanë një agjendë të ndryshme, lulëzojnë në hapësira të ndryshme, mirëpo pajtohen për disa rregulla bazë rreth institucioneve demokratike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Askush nuk kërkon nga Papa që ai ta rishikojë qëndrimin e tij rreth abortit në mënyrë që ai të pranohet si një evropian “i vërtetë”.

Fetë nuk mund të futen nën zgjedhën e politikës dhe kjo është arsyeja, tekefundit, pse demokracitë kanë krijuar pak a shumë një ndarje të qëndrueshme midis kishës dhe shtetit.

Problemi i Evropës me emigrantët e saj muslimanë, patologjia e Njerëzve Në Mes, a do të ekzistonte edhe sikur të ishte një shtet i pavarur, në lulëzim e sipër i Palestinës dhe sikur SHBA-të, Britania dhe disa shtete të tjera evropiane të mos e pushtonin Irakun?

Roy: Po, sigurisht. Ne priremi ta mbivlerësojmë ndikimin e krizës së Lindjes së Mesme në radikalizimin (ose mungesën e radikalizimit) ndër muslimanët që jetojnë në Perëndim. Një demonstratë pro-Palestiniane në Paris asnjëherë nuk nxjerr në rrugë më shumë se 10'000 demonstrues, ndërkohë që në dhe rreth Parisit jetojnë nga 2 deri 3 milionë muslimanë potencialë. Vrasësi i Theo van Goghut në Holandë asnjëherë nuk e ka zënë në gojë Irakun, Afganistanin apo Palestinën, por vetëm blasfeminë. Ne këtu përballemi me një problem breznish (siç ka ndodhur pikërisht, p.sh., në vitet 1970 këtu me ultra-majtistët evropianë), e jo me ndonjë çështje gjeostrategjike. Dhe, në këtë kontekst, Bin Ladini e ka sulmuar Nju Jorkun para e jo pas pushtimit të Irakut nga ana e SHBA-ve.

Rrënjët e radikalizimit janë brenda Perëndimit, e jo në Lindjen e Mesme. Le ta trajtojmë fillimisht çështjen e integritetit të muslimanëve dhe të Islamit si një fe perëndimore dhe le të pushojmë të fokusohemi në luftërat e Lindjes së Mesme, për çka nuk kemi asnjëfarë fuqie, dhe prej të cilave muslimanët evropianë janë shumë-shumë larg sesa që mendojmë ne shpesh. I ashtuquajtur i zemërimi musliman kundër Perëndimit nuk e ka prekur pjesën dërmuese të muslimanëve perëndimorë, përveç në Britani të Madhe, mirëpo në kontinentin e Evropës radikalizimi i Islamit ka të bëjë vetëm me një pjesë të vogël të muslimanëve të çrrënjësuar të gjeneratës së dytë. Ata nuk ekzistojnë në realitet, përpos se në ankthet tona.